

Në lidhje me kërkesën, ju bëjmë me dije se:

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (këtu e në vijim “Fondi”) ushtron veprimtarinë e tij në zbatim të Ligjit Nr. 10 383, datë 24.02.2011, “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në nenin 10 të këtij ligji parashikohet se sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen:

- vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor publik dhe në spitalet publike;
- vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në dhënës privat të kujdesit parësor dhe spitale private;
- barnat, produktet dhe trajtimet mjekësore nga dhënës të kontraktuar shërbimesh shëndetësore.

Në bazë të nenit 29, pika 3, “Fondi lidh kontratë me dhënësit publikë të shërbimit shëndetësor, të licencuar nga autoriteti kompetent, dhe mbulon të gjitha shërbimet e ofruara nga dhënësi, të cilat janë të përfshira në paketën e shërbimeve”, financon shërbimet shëndetësore të ofruaja sipas nenit 10 të këtij ligji.

Në bazë të Kontratës së nënshkruar ndërmjet Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë dhe Fondit (DSHSU), Fondi disponon informacion për numrin e pacientëve të shtruar në dhe numrin e pacientëve të konsultuar në konsultën ambulatorë.

Të shtruar dhe konsultë ambulatorë:

Viti	Shërbimi	Pacientë	Konsultë ambulatorë
2020	Onkologji	17,541	24,946
2021	Onkologji	23,254	28,824
2022	Onkologji	21,626	31,438
2023	Onkologji	20,262	32,633
2024	Onkologji	21,275	34,317
		103,958	152,158